



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:231179
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05370567

C - IV - 15 - 1406

Paditësja:

NTP, "K C me seli në Prishtinë, e të cilën e përfaqëson, pronari, S M nga Prishtina.

Kundër

Të paditurës:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lagjja, "Lakrishtë", Prishtinë e.

Objekti i çështjes : Kompensimi për mos përmbushjen në tërësi të kërkesës në emër të fitimit të humbur.

Për: Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjykatësin, Agron Hoxhaj, me **dt.26.02.2024**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadija e paditëses, NTP,"K C me seli në Prishtinë e paraqitur kundër të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, dhe Vendimi, PRN008 – 0080 i dt.10.06.2015 i të paditurës, Autoriteti i Likuidimit (AL) i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "I.M.F Kosova" me seli në Fushë Kosovë, **VËRTETOHET** si drejtë dhe i bazuar në ligj.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike:

Me datën 24.07.2015, paditësja, NTP,"K C me seli në Prishtinë, në DhPGJSK, ka parashtruar padi kundër të paditurës, Autoriteti i Likuidimit (AL) i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë e me të cilën ka kërkuar kompensimin në emër të fitimit të humbur dhe atë për dëmin (kamatën ligjore) ashtu siç e parasheh ligji si dhe shpenzimet e procedurës dhe se kjo padi lidhet me Vendimin, PRN008 – 0080 të dt.10.06.2015 të lëshuar nga

Autoriteti i Likuidimit (AL) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) lidhur me

NSh, "I.M.F Kosova" me seli në Fushë Kosovë (në likuidim), e me të cilin, paditëses, i është pruar kërkesa për kompensim në emër të fitimit të humbur përkatsisht për kompensimin e mallit të shitur në shumën e përgjithshme prej 51.624.99 €.

Paditësja në këtë padi, ka kërkuar që të detyrohet e paditura që asaj si paditëse, t'ia paguaj borxhin në vlerë prej 333,200.00 DIN të konvertuar 51.624.99 €, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës, se Autoriteti i Likuidimit, duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga paditësi si dhe ekspertiza e ka aprovuar kërkesën e saj, nr.0080 dhe me Vendimin, nr.5052/2015 të dt.11.06.2015, ia ka miratuar kërkesën e paraqitur nga paditësja e me të cilin ka kërkuar kompensimin në emër të fitimit të humbur si dhe kompensimin e vlerës së mallit të shitur nga NSh, "I.M.F Kosova" (në likuidim), dhe se Autoriteti i Likuidimit, me këtë Vendim e pranon vetëm borxhin bazë por jo edhe kamatën ligjore ashtu siç ka kërkuar paditësja dhe si e përcakton ekspertiza financiare e përpiluar nga eksperti gjyqësor i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, kërkesa me aktvendim nga AKP – Autoriteti i Likuidimit, e meqë kërkesa e paditëses vetëm pjesërisht është përmbushur e jo në tërësi, paditësja në afatin e lejuar ligjor paraqet këtë kërkesëpadi dhe i propozon gjykatës që pas zhvillimit të procedurës të marr aktvendim, e m me të cilin detyrohet e paditura, AKP- ja, Autoriteti i Likuidimit që paditëses, NTP, "K C me seli në Prishtinë, t'ia kompensoj pjesën e dëmit (kamatën ligjore) ashtu siç e parasheh ligji si dhe shpenzimet e procedurës.

Paditësja, padisë së saj, si prova ia ka bashkagjitur: Vendimin, PRN008 – 0080 të dt.10.06.2015 të AL-së, shkresën e prioritetit të kërkesave dhe interesave, aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut, I.C.nr.253/2007 të dt.27.02.2008 për ndërprerjen e procedurës, dhe ekspertizën financiare të dt.27.08.2021 të ekspertit gjyqësor financiar, R B nga Prishtina në shumën prej 40.293.07 € për kamatën ligjore.

Me dt.05.06.2023, e paditura, AKP me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë, ka parashtruar mbrojtjen e saj në padinë e paraqitur nga pala paditëse e ndër të tjera në këtë mbrojtje, ka theksuar se me rastin e vendosjes, Autoriteti i Likuidimit mori Vendimin, duke miratuar kërkesën në bazë të aktgjykimit, VI C.nr.120/2007 dt.18.10.2007 në shumën 51.677.00 euro + 1.580.00 euro si shpenzime gjyqësore + 5.160.00 euro si kamat mbi vlerën të pranuar nga gjykata, ndërsa e refuzuar në shumën 29.367.00 euro në bazë të neni 37.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP-në, i cili parashikon shumën e kamatës të miratuar nga AL-ja, në vlerën prej 10%, e cila dispozitë zbatohet përkundrajt çdo dispozite tjetër në legjislacion që është në kundërshtim me të në përpurthje me nenin 31 Ligjit 04/L-034 për AKP, për pala kundërshtare i paraqet gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme / të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL-së.

Me dt.05.06.2023, DhPGJSK-ja, me Urdhrin e saj, C- IV. – 15 – 1406 të dt.05.06.2023, mbrojtjen e të paditurës, ia ka dërguar paditëses dhe se e njëjta me dt.14.06.2023, ka paraqitur Përgjigje në këtë mbrojtje e në të cilën, në mes tjerash ka theksuar se sipas Vendimit të dt.10.06.2015 me numër, PRN008 – 0080, është bërë pagesa edhe atë në shumën prej 75 % të vlerës, pra më saktësisht 38.718.00 euro edhe atë në vitin 2018 (më saktësisht 3 vite pas vendimit të gjykatës) e që kjo gjë nuk është e specifikuar në asnjë shkresë, tani pos që nuk është bërë pagesa evlerës së saktë të përcaktuar me aktvendimin e gjykatës, pra në vlerën prej 51,624.99 euro mirëpo nuk është bërë pagesa e kamatëvonesës për këtë çështje, se paditësja ka kërkuar nga ana e gjykatës kompetente që të e detyroj të paditurën që të bëjë ekzekutimin e vendimit të gjykatës e duke e detyruar të njëjtën që të bëjë pagesën e mbetur në vlerën prej 12,906.15 euro si dhe kamatën sipas vendimit të gjykatës të përcaktuar në vlerën prej 51,624.99 euro pas përpilimit të ekspertizës financiare të ekspertit i cili do të përcaktoj saktë vlerën e kërkuar si dhe pjesën e fitimit të humbur për këtë periudhë për shkak të dëmeve që i janë shkaktuar për shkak

të vonesave në pagesë të borxhit kryesor, e me propozimin që gjykata të aprovoj kërkesëpadinë e paditëses, si të bazuar, të obligohet e paditura që paditëses, t'ia kompensoj në emër të demit dhe atë në emër të përmbushjes së plotë të obligimit të paguaj shumën e mbetur të obligimit 12,906.15 euro, në emër të kamatës ligjore të bëjë pagesën pas ekspertizës që do të bëhet nga ana e ekspertit financiar, në emër të fitimit të humbur për vonesën e mos pagesës, shumën që do t'a përcaktoj pas marrjes së ekspertizës nga ana e ekspertit financiar respektivisht shumën të cilën paditësja do t'a precizoj në shqyrtimin kryesor pas marrjes së mendimit nga ekspertët përkatës për llojin dhe lartësinë e demit, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar prej datës 27.02.2008 e deri në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit krejtë këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit e më gjerësisht si në këtë Përgjigje .

Me dt.29.06.2023, e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë ka parashtruar Kundërpërgjigjen e në të cilën, ka cekur se e paditura deri më tani nuk ka paraqitur asnjë argument të rim bi të cilat do t'i mbështeste pretendimet e saj e të cilat nuk janë trajtuar nga AL-ja më herët, se AL-ja është bazuar në vendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut mbi caktimin e ekspertizës financiare, paditëses, ia ka pranuar të drejtën e kompensimit në shumën prej 51,624,99 €, se sa i përket kërkesave tjera aksesore, siç është pagesa e kamatës, AL-ja, ka vërejt se leximi i propozuar nga parashtruesi në nenin 37.7 të Ligjit, Nr.04/L – 034, është i pa saktë sepse ky nen nuk lejon që këto shuma të llogaritura mbi shumën themelore të tejkalojnë 10 %, pra neni 37.7 i Ligjit, Nr.04/L – 034, iu zbatohet në të njëjtën mënyrë edhe kreditorëve të tjerë dhe favorizimi i pa justifikuar i parashtrueses e këtu paditëses, se AL-ja, kërkon nga gjykata që t'a vlerësoj pranueshmërinë e kërkesës së paditëses pasi që e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 66.1 dhe nenin 74.2 të Ligjit, Nr,06/086, duke mos e bashkëlidhur një kopje të vendimeve të ankimuara, se DhPGJSK-ja, ka juridikcion vetëm për ligjshmërinë e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, se duke marr parasysh se ankesa është e pabazuar, i propozon gjykatës që të refuzoj parashtruesën si të pabazuar dhe/apo të papranueshme dhe t'a vërtetoj (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit e më gjerësisht si në këtë kundërpërgjigje.

Me dt.06.07.2023, kjo gjykatë, kundërpërgjigjen e të paditurës, AKP-së, ia ka dërguar paditëses.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata marr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par.1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses, duhet të refuzohet si e pabazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditëses.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se NSh, "I.M.F Kosova" me seli në Fushë Kosovë (në likuidim), ka hyrë në procedurën e likuidimit me dt.21.05.2008 ndërsa paditësja kërkesën tek AL-ja, e ka bërë para afatit për dorëzimin e kërkesave në procedurën e likuidimit dhe atë me dt.04.03.2008 kurse AL-ja me Vendimin e tij, PRN008 – 0080 i dt.10.06.2015, kërkesën e paditëses për kompensimin në emër të fitimit të humbur përkatësisht për kompensimin e mallit të shitur në shumën e përgjithshme prej 51.624.99 €, ia ka pranuar e më gjerësisht si në këtë Vendim të AL-së derisa paditësja, pas pranimit të këtij Vendimi në procedurën e likuidimit, pas dt.11.06.2015, ankesën kundër Vendimit të AL-së, PRN008 – 0080 të dt.10.06.2015, pranë DhGJSK-së, e ka paraqitur me dt.01.03.2015, pra para afatit ligjor prej 30 ditëve për paraqitjen e ankesës/ padisë dhe se padisë së saj, paditësja, ia bashkangjitur një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi pra Vendimin e AL-së, PRN008 – 0080 të dt.10.06.2015 për Ndërmarrjen Shoqërore, NSh, "I.M.F Kosova" me seli në Fushë Kosovë (në likuidim).

Gjykata, vlerëson se padia/ankesa e paditëses, i plotëson kriteret e afatshmërisë dhe pranueshmërisë nga neni 36 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-por edhe se e njëjta padi pranë e DhPGJSK-së është bërë brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të Vendimit të kontestuar të AL-së, PRN008 – 0080 të dt.10.06.2015 për Ndërmarrjen Shoqërore, NSh, "I.M.F Kosova" me seli në Fushë Kosovë (në likuidim).

Faktet jo kontestuese dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata gjen se nuk është kontestuese e paditura, NSh, "I.M.F Kosova" me seli në Fushë Kosovë (në likuidim) e të cilën e menaxhon AKP-ja me seli në Prishtinë, ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.21.05.2008, ndërsa paditësja kërkesën tek AL-ja, e ka bërë para afatit për dorëzimin e kërkesave në procedurën e likuidimit ligjor dhe atë me dt.04.03.2008 kurse AL-ja me Vendimin e tij, PRN008 – 0080 i dt.10.06.2015, kërkesën e paditëses për kompensimin në emër të fitimit të humbur përkatësisht për kompensimin e mallit të shitur në shumën e përgjithshme prej 51.624.99 €, paditëses në procedurën e likuidimit, ia ka pranuar në pajtim me neni 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L - 034 për AKP-në, si dhe duke u bazuar në ekspertizën financiare të përpiluar nga eksperti gjyqësor i Gjykatës Ekonomike të Qarkut por kontestuese paraqitet kërkesa e paditëses për t'a detyruar të paditurën që t'ia paguaj të paditurën që të bëjë ekzekutimin e vendimit të gjykatës e duke e detyruar të njëjtën që të bëjë pagesën e mbetur në vlerën prej 12,906.15 € si dhe kamatën sipas vendimit të gjykatës të përcaktuar në vlerën prej 51,624.99 € pas përpilimit të ekspertizës financiare të ekspertit i cili do të përcaktoj saktë vlerën e kërkuar si dhe pjesën e fitimit të humbur për këtë periudhë për shkak të dëmeve që i janë shkaktuar për shkak të vonesave në pagesë të borxhit kryesor, e me propozimin që gjykata të aprovoj kërkesëpadinë e paditëses, si të bazuar, të obligohet e paditura që paditëses, t'ia kompensoj në emër të demit dhe atë në emër të përmbushjes së plotë të obligimit të paguaj shumën e mbetur të obligimit 12,906.15 euro, në emër të kamatës ligjore të bëjë pagesën pas ekspertizës që do të bëhet nga ana e ekspertit financiar, në emër të fitimit të humbur për vonesën e mos pagesës, shumën që do t'a përcaktoj pas marrjes së ekspertizës nga ana e ekspertit financiar dhe atë pas marrjes së mendimit nga ekspertët përkatës për llojin dhe lartësinë e demit, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar prej datës 27.02.2008.

Neni 37 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) që flet

për Llogaritjen dhe kompensimi i kërkesave, parashihet se : *''Dispozitat e këtij neni kanë efekt superior mbi dispozitat e mundshme kontraktore të kontratave, zgjidhjeve, marrëveshjeve, aktgjykimeve apo rregullimeve tjera të lidhura nga Ndërmarrja apo në emër të saj ...Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore''.*

Në nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që parasheh Prioritetet e kërkesave dhe interesave, thuhet se : *''Në procedurat e likuidimit të gjitha Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë''.*

Ndërsa në nenin 42.3 i Ligjit, Nr. 06/L – 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se *“... Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë''.* Andaj gjykata konstaton se mbi bazën e fakteve të paraqitura të paditëses para AL-së si dhe tani para gjykatës, nuk i merr si të besueshme për aprovimin e kërkesës së saj lidhur me detyrimin e të paditurës për t'a detyruar të paditurën që paditëses, t'ia bëjë pagesën e mbetur në vlerën prej 12,906.15 eurove dhe në emër të kamatës ligjore sepse DhPGJSK-ja, nuk ka juridikcion në përmbartimin e vendimeve të AL-së sepse kjo bëhet nga Autoriteti i Likuidimit sipas prioritetit të kërkesave dhe sipas gjendjes së fondit (mjeteve monetare) për NSH-në në fjalë derisa është e pa bazuar edhe pjesa e kërkesës në emër të dëmit të shkaktuar (kamatën ligjore), në emër të fitimit të humbur për vonesën e mos pagesës, shumën që do t'a përcaktoj pas marrjes së ekspertizës nga ana e ekspertit financiar respektivisht shumën të cilën paditësja do t'a precizoj në shqyrtimin kryesor pas marrjes së mendimit nga ekspertët përkatës për llojin dhe lartësinë e dëmit, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar prej datës 27.02.2008 e deri në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit sepse AL-ja pas shqyrtimit të fakteve vendimtare lidhur me provat e prezantuara, ka gjetur se me Vendimin e tij, PRN008 – 0080 i dt.10.06.2015, drejtë ka vepruar kur paditëses, ia ka pranuar kërkesën e saj për kompensimin në emër të fitimit të humbur përkatësisht për kompensimin e mallit të shitur në shumën e përgjithshme prej 51.624.99 € dhe atë duke iu bazuar në nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L - 034 për AKP-në, si dhe duke u bazuar në ekspertizën financiare të përpiluar nga eksperti gjyqësor i Gjykatës Ekonomike të Qarkut.

Gjykata vlerëson se me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, nuk e gjeti të arsyeshme që të caktoj seancën dëgjimore lidhur me çështjen e ekspertizës financiare të dt.27.08.2021 të ekspertit gjyqësor financiar, R B nga Prishtina në shumën prej 40.293.07 € për kamatën ligjore si kërkesë aksesore për borxhin kryesor nuk e mor për bazë provën – ekspertizën financiare në fjalë sepse e njëjta, në procedurën e likuidimit, nuk ka prova se e ka bërë një kërkesë të tillë dhe se Vendimi i marr nga AL-ja, PRN008 – 0080 i dt.10.06.2015, është marrë bazuar në ekspertizën financiare të hartuar – përpiluar nga eksperti gjyqësor i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë dhe e cila është bazuar në këtë ekspertizë derisa janë të pa bazuara edhe pjesët tjera të kërkesave të paraqitura nga paditësja, përmes Përgjigjes së dhënë në mbrojtjen e të të paditurës, nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit në këtë procedurë gjyqësore pasi që këto kërkesa nuk janë paraqitur në procedurën e likuidimit, pra përfshirë edhe të drejtën e saj në kompensim në emër të dëmit të shkaktuar, në emër të fitimit të humbur për vonesën e mos pagesës si dhe kamatën ligjore prej 8 % duke filluar prej datës 27.02.2008 e deri në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.

Gjykata vlerëson se, është i bazuar qëndrimi i të paditurës i shprehur në Vendimin e AL-së, PRN008 – 0080 i dt.10.06.2015 kur kërkesën e paditëses, e ka pranuar në tërësi kërkesën e paditëses për kompensim në emër të fitimit të humbur përkatësisht për kompensimin e mallit të shitur në shumën e përgjithshme prej 51.624.99 € si dhe duke u bazuar në ekspertizën financiare të përpiluar nga eksperti gjyqësor i Gjykatës Ekonomike të Qarkut e duke u bazuar në nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në derisa kërkesat tjera në emër të përmbushjes së plotë në vlerën prej 12,906.15 eurove, si pjesë e detyrimit të mbetur në të holla në emër të fitimit të humbur përkatësisht për kompensimin e mallit të shitur nga shumës e përgjithshme prej 51.624.99 €, është në kompetencën e AL-së për përmbushjen e kërkesave sipas prioritetit të tyre dhe sipas gjendjes së fondit (mjeteve monetare) për NSh-në në fjalë kurse pjesa tjetër e kërkesës në emër të kamatës ligjore, si dhe në emër të fitimit të humbur për vonesën e mos pagesës e bazuar në ekspertizën financiare të dt.27.08.2021 të ekspertit gjyqësor financiar, R B nga Prishtina në shumën prej 40.293.07 € për kamatën ligjore si kërkesë aksesore për borxhin kryesor, të përpiluar në bazë të kërkesës së paditëses, si dhe kamatën ligjore prej 8 % e duke filluar prej datës 27.02.2008 e deri në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit, janë kërkesa që i tejkalojnë kërkesat e trajtuara në Autoritetin e Likuidimit, andaj edhe të njëjta kërkesa nuk kanë bazë ligjore për shqyrtim pranë kësaj gjykate dhe se kjo gjykatë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:231179, 26.02.2024

**Gjykatësi
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës